

Marketing & Distribution sh.p.k.
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

FAQJA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	i-iii
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	6
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA PËRMBLEDHËSE	7
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	8
PASQYRA E RRJEDHËS SË MJETEVE MONETARE	9
SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	10-29

(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)

1. HYRJE

Marketing & Distribution sh.p.k. (Shoqëria) është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, e vendosur në Republikën e Shqipërisë dhe e regjistruar më 8 shtator 1997 në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Adresa e zyrave qendrore është në Kashar, Autostrada Tiranë – Durrës, km 10.

Struktura e kapitalit të Shoqërisë përbëhet nga 100% të totalit të kapitalit të nënshkruar të aksioneve nga Vilma Nushi.

Aktiviteti kryesor i biznesit të Shoqërisë përfshin importimin, magazinimin, ruajtjen, eksportimin, shitjen me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshme, përfshirë ato ushqimore, bujqësore e blegtorale, industriale, lëndë të parë minerare, si dhe të çdo lloj malli tjetër.

Gjithashtu Shoqëria ka si aktivitet ushtrimin e veprimtarisë së Duty Free Shop, në përputhje me dispozitat në fuqi. Shoqëria ka gjithashtu të drejtë të ketë pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare si dhe të ndërmarrë çdo akt financiar, ekonomik apo tregtar të lidhur me objektin kryesor të saj.

Më 31 dhjetor 2022, Shoqëria ka të punësuar 394 punonjës (më 31 dhjetor 2021: 396 punonjës).

2. BAZA E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazën e përlogaritjes të specifikuar nga SNRF për secilin lloj të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë përshkruar më gjerësisht në politikat kontabël më poshtë. Shoqëria ka vendosur të publikojë pasqyrat financiare të konsoliduara në një datë të mëvonshme nga publiimi i pasqyrave financiare individuale. Publikimi i tyre me vonesë nuk ka efekt material për shoqërinë.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe paraqitur në monedhën shqiptare Lek ("LEK"), monedhë e vëndit në të cilin Shoqëria zhvillon aktivitetin. Politikat kryesore kontabël janë shpjeguar më poshtë.

2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në ato pasardhëse të ndikuara. Në veçanti, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Vlerësimi kontabël më i rëndësishëm për kompaninë është ai që lidhet me recuperueshmërinë e llogarive të arkëtueshme. Administratorët e kompanisë klasifikojnë si indikacion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme momentin kur marrëdhëniet e biznesit me klientin janë ndërprerë dhe kanë filluar proceset gjyqësore që lidhen me klientin. Per qellime të hartimit të ketyre pasqyrave financiare detyruesat në arketimin e shërbimeve nuk konsiderohet si indikacion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme të shoqërisë.

(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)

2. BAZA E PËRGATITJES (VAZHDIM)

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve(vazhdim)

Efektive 1 janar 2022 shoqëria ka ndryshuar vlerësimet kontabel në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata për të cilat nuk janë finalizuar procedurat e marrjes së titullit të pronësive. Shoqëria ka vlerësuar që data e fillimit të amortizimit të këtyre aktiveve të jetë data e marrjes së titullit të pronësive. Në datën e këtyre pasqyrave nuk ka indikacione që vlera kontabel e këtyre aktiveve të ketë ndryshime nga vlera e tregut e tyre.

2.5 Vijimësia

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me parimin e vijimesisë, i cili supozon se shoqëria do të vazhdojë të operojë për një periudhë të parashikueshme në të ardhmen. Drejtimi i shoqërisë beson se ka aktive të mjaftueshme dhe se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim të biznesit të shoqërisë në kushtet aktuale. Aftësia e shoqërisë për të vazhduar aktivitetin do të varet gjithashtu dhe nga mbështetja financiare nga aksioneri i saj.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Standardet e reja dhe të rishikuara efektive për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Standardet e mëposhtme, të cilat janë kryesisht amendime të standarteve ekzistuese dhe interpretime të nxjerra nga Bordi Ndërkombëtar i Standarteve Kontabël janë efektive për periudhën aktuale. Standardet e ndryshuara në vijim hynë në fuqi më 1 janar 2020, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material tek Shoqëria:

- Kontrata me kushte renduese-Kostot e permbushjes së një kontrate, Referenca ndaj Kuadrit Konceptual-Ndryshime në SNK 16, SNK 37 dhe SNRF (publikuar më 14 maj 2020 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022).

3.2 Standarde dhe interpretime të publikuara që nuk janë ende të aplikueshme

Në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma nuk ishin në fuqi.

- Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Shoqërisë ose Sipërmarrjes së Përbashkët të tij - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të publikuara më 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm – Ndryshimet në SNK 12 (publikuar më 7 maj 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023).
- Opsioni i tranzicionit për siguruesit që zbatojnë SNRF 17 – Ndryshimet në SNRF 17 (publikuar më 9 dhjetor 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023);
- Ndryshimet në SNRF 16 Qiratë: Detyrimi i Qirasë në një shitje dhe kthim me qira (lëshuar më 22 shtator 2022 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024);
- Klasifikimi i detyrimeve si korrente ose afatgjata – Ndryshime në SNK 1 (fillimisht i lëshuar më 23 janar 2020 dhe i ndryshuar më pas më 15 korrik 2020 dhe 31 tetor 2022, përfundimisht në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2024);

Shoqëria ka vendosur të mos i adaptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Drejtimi parashikon se adoptimi i këtyre standarteve nuk do të ketë impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën fillestare të zbatimit.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME (VAZHDIM)**3.3 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit janë njohur në fitim dhe humbje. Zërat jo monetarë që maten në bazë të kostos historike në monedhë të huaj (konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit), përveç zërave jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë të cilët konvertohen me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e raportimit janë si vijon:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
LEK / EUR	114.23	120.76
LEK / USD	107.05	106.54

3.4 Aktivët afatgjatë materiale*(i) Njohja dhe matja*

Zëri aktivët afatgjatë materiale është matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar (shiko më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kostoja historike përfshin shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara për aktivin. Kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të veçantë (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjatë materiale.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale është njohur në vlerën kontabël të zërit në qoftë se është e mundur që në të ardhmen përfitimet ekonomike të përfshira në atë zë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjatë materiale njihen në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Aktivët afatgjatë materiale amortizohen bazuar në metodën e vlerës së mbetur (siç kërkohet nga Legjislacioni i Tatimeve Shqiptare). Në lidhje me përmirësimet e aktiveve të dhëna me qera shoqëria ka vendosur të aplikojë efektive në 1 Janar 2022 SNRF 16 Qeratë. Ndersa amortizimi për të gjitha ndërtimet për të cilat nuk janë finalizuar procedurat e marrjes së titujve të pronësisë është zero për qind.

Normat e amortizimit të përdorura janë si më poshtë:

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**3.4 Aktivet afatgjata materiale (VAZHDIM)**

<u>Kategoritë e aktiveve</u>	<u>Norma e Amortizimit</u>
Ndërtesa	5%
Ndërtime në proces hipotekimi	E Pacaktuar
Automjete	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	20%
Pajisje IT	25%
Pajisje dhe makineri	20%

3.5 Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivët afatgjatë jo materiale, të cilat konsistojnë tërësisht në vepra arti, emri i mirë dhe pjesëmarrje në aksione, janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën mbi vlerën e mbetur. Norma e amortizimit e përdorur për aktivët afatgjatë jo materiale është 0%. Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportimi dhe efektet e ndonjë ndryshimi në vlerësim rregjistrohen në bazë prospektive.

3.6 Qiratë

Shoqëria ka implementuar për herë të parë Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar në lidhje me qiratë SNRF 16. Shoqëria ka zgjedhur që efektet që lindin nga aplikimi për herë të parë i SNRF-ve të raportohen në pasqyrat financiare të vitit që mbyllet me 31 dhjetor 2022 pa kryer modifikime në pasqyrat e vitit që mbyllet me 31 dhjetor 2021 dhe 2020. SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019), përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirasë. Të gjitha qiratë rezultojnë që qiramarrësi merr të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të periudhës së qirasë dhe nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës, gjithashtu merr financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qira operative ose qira financiare siç kërkohej nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilizimeve nga qiramarrësit.

Shoqëria ka njohur: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, pasi nuk ka pasur raste kur aktivi është me vlerë të ulët; dhe (b) amortizimin e aktiveve të marra me qira veçmas nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

SNRF 16 mbart të njëjtat kërkesa për kontabilizimin e qirasë nga qiradhënësit si SNK 17, por që tek Shoqëria nuk ka impakt.

*Matja fillestare**Matja fillestare e aktivitetit me të drejtë përdorimi*

Në datën e fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit mat aktivin me të drejtë përdorimi me kosto. Kosto e aktivitetit me të drejtë përdorimi do të përfshijë;

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë sic përshkruhet më poshtë;
- çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit minus cdo stimul qiraje të marre;
- çdo kosto fillestare të drejtëpërdrejtë të kryer nga qiramarrësi; dhe
- dhe një vlerësim të kostove që do të ndodhin nga qiramarrësi për cmontimin dhe lëvizjen e aktivitetit bazë.

(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.6 Qiratë (vazhdim)

Matja fillestare e detyrimit të qirasë

Në datën e fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit e mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar në atë datë. Pagesat e qirasë skontohej duke përdorur normën e interesit të përcaktuar të qirasë, nëse kjo normë përcaktohet lehtë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, qiramarrësi do të përdor normën rritëse të huamarrjes së Shoqërisë.

Matja e mëpasshme

Matja e mëpasshme e aktivitetit me të drejtë përdorimi

Pas datës së fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit e mat aktivin me të drejtë përdorimi duke përdorur modelin e kostos.

Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë

Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë bëhet si më poshtë:

- a) duke rritur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar interesin në detyrimin e qirasë;
- b) duke pakësuar vlerën kontabël (neto) për të reflektuar pagesat e qirasë;
- c) duke rimatur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar cdo rivlerësim ose modifikim të qirasë.

3.7 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë, janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi njihet në qoftë se vlera e mbartur e aktivitetit e kalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitim ose humbje.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësisë së tij gjeneruese të parasë, tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm aktivesh që gjeneron rrjedhje parash që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në të ardhura dhe shpenzime. Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose një njësie gjeneruese të parasë, është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhja e pritshme e ardhshme e parasë është skontuar me vlerën aktuale duke përdorur normën e skontimit para taksës që reflekton vlerën aktuale të parasë në treg dhe rreziqet specifike të aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që humbja nga zhvlerësimi nuk ekziston më dhe që ka patur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm nëse vlera kontabël e aktivitetit nuk e kalon vlerën që do të ishte përcaktuar, neto me zhvlerësimin ose amortizimin, nëse zhvlerësimi nuk do të ishte njohur.

(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.8 Inventari

Inventari matet me më të voglën midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është vlerësuar me çmimin e shitjes gjatë aktivitetit normal minus kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Kostoja e inventarit pëcaktohet bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e konvertimit dhe kosto të tjera të ndodhura gjatë sjelljes së inventarit në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale.

3.9 Instrumentat Financiare

Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo-derivativ që përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, huatë dhe llogari të pagueshme dhe të tjera. Instrumentat financiar jo-derivativ njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat jo në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, duke i shtuar çdo kosto që lidhet drejtpërdrejtë me transaksionin. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiar jo-derivativ maten si më poshtë. Një aktiv financiar njihet nëse Shoqëria bëhet pjesë në kushtet kontraktuale të aktivitetit. Shoqëria ç'regjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi rrjedhjen e mjeteve monetare nga aktivet financiare skadojnë ose në qoftë se ajo transferon të drejtat për të arkëtuar rrjedhjen e mjeteve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivitetit financiar transferohen. Blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare regjistrohen në datën e tregtimit, p.sh. data në të cilën Shoqëria angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivitetit. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuar në kontratë skadojnë ose janë hequr ose anuluar.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë të cilat kanë maturitet tre muaj ose më pak, të cilat nuk janë subjekt i rreziqeve të rëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Shoqëria për manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme krijohet kur ka tregues objektiv që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të llogarive të arkëtueshme.

Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose të ndodhë një riorganizim financiar dhe mospagesa konsiderohen indikatorë që llogaritë e arkëtueshme janë zhvlerësuar.

(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.9 Instrumentat Financiare(Vazhdim)

Shuma e provigjoni është diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të rrjedhjes së ardhshme të mjeteve monetare, të skontuara me normën e interesit efektiv. Aktivitetet me maturitet afatshkurtër nuk skontohen. Vlera kontabël e aktivitetit zvogëlohet përmes përdorimit të një llogarie provigjoni dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje. Kur një llogari e arkëtueshme është e pambledhshme, vlera në bilanc mbyllet kundrejt një provigjoni për këtë llogari. Nëse shumat rikuperohen më vonë, ato regjistrohen në fitim ose humbje.

Huatë

Pas njohjes fillestare, huatë që mbartin interes regjistrohen me kosto të amortizuar me çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së rimarrjes dhe njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes mbi bazën e interesit efektiv.

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe në vazhdimësi maten me koston e amortizuar.

Njohja e zhvlerësimit të aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka tregues objektiv që tregon se një ose disa ngjarje kanë patur një ndikim negativ në rrjedhjen e ardhshme të mjeteve monetare të vlerësuara të aktivitetit financiar.

Një zhvlerësim në vlerë në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të rrjedhjes së ardhshme të mjeteve të parasë të vlerësuara duke i skontuar me normën origjinale të interesit efektiv të aktivitetit.

Aktivitetet financiare individualisht të rëndësishme testohen për zhvlerësim mbi bazë individuale. Aktivitetet e mbetura financiare vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse kthimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi zhvlerësimi është njohur. Rimarrja njihet në fitim dhe humbje.

3.10 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë nga Shoqëria. Të ardhurat reduktohen për kthimet e vlerësuara të klientit, uljet, skontot apo të tjera zbritje. Të ardhurat kryesore vijnë nga shitja me pakicë e mallrave.

(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.10 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Shitja e mallrave

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë plotësuar:

- Shoqëria ka transferuar tek blerësi rreziqet domethënëse dhe shpërblimet që lidhen me pronësinë e mallrave ;
- Shoqëria nuk zotëron përfshirje menaxheriale në shkallën që zakonisht lidhet me pronësinë dhe kontrollin efektiv mbi mallrat e shitura ;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri ;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike dhe
- Shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri.

3.11 Të ardhura nga interesat

Të ardhurat nga interesat përlogariten në bazë kohore, duke iu referuar principalit të papaguar dhe normës së interesit efektiv.

3.12 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet e detyrueshme të pensioneve sipas legjislacionit vendor. Kostot të kryera në emër të Shoqërisë janë të paraqitura në të ardhura ose shpenzime në momentin e që ndodhin.

3.13 Tatimi mbi fitimin i periudhës dhe i shtyrë

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin është 15% (2021: 15%) e të ardhurës së tatueshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke paraqitur diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv për tatimin e shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme të ardhshme do të realizohen kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me të. Detyrimet për tatimin e shtyrë njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme.

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.14 Provigjonet

Provigjonet njihen kur si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime (ligjore ose konstruktive) të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Nëse efekti është material, provigjonet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të rrjedhës së mjeteve monetare të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimeve. Provigjonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më mundësi që një rrjedhje burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, të jetë e nevojshme për mbylljen e detyrimit, provigjonet rimerren. Provigjonet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Nuk njihet provigjon për humbjet e ardhshme operative.

3.15 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Për një detyrim të kushtëzuar jepet informacion shpjegues vetëm kur mundësia e një daljeje burimesh që përfshin përfitime ekonomike nuk ekziston më. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por jepet informacion shpjegues kur realizimi i të ardhurave është i mundur. Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundur që ngjarje të ardhshme ta konfirmojnë atë, një detyrim që ka lindur deri më datën e raportimit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i humbjes.

Marketing & Distribution Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)***4. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE**

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021 janë të përbëra si më poshtë:

	Ndertesa	Automjete	Pajisje IT	Pajisje zyre	Pajisje dhe makineri	Total
Kosto						
Më 31 dhjetor 2020	1,420,448,969	553,344,061	162,835,789	327,021,889	771,646,347	3,235,297,055
Shtesa	30,016,211	10,839,750	6,205,220	80,889,036	84,898,815	212,849,032
Pakesime	(78,896,597)	(22,399,947)	(793,191)	(35,848,537)	(2,441,239)	(140,379,511)
Më 31 dhjetor 2021	1,371,568,583	541,783,864	168,247,819	372,062,388	854,103,923	3,307,766,577
Shtesa	4,622,506	4,820,895	8,523,138	98,986,963	60,462,535	177,416,036
Pakesime	(1,447,029)	(22,235,805)	-	(1,402,618)	(454,483)	(25,539,935)
Më 31 dhjetor 2022	1,374,744,060	524,368,954	176,770,956	469,646,733	914,111,974	3,459,642,678
Amortizimi i akumuluar						
Më 31 dhjetor 2020	237,736,363	336,862,221	123,705,965	214,308,539	455,804,523	1,368,417,611
Shtesa	32,148,164	44,186,158	7,248,709	35,968,178	65,683,775	185,234,984
Pakesime	-	(20,126,959)	(613,519)	-	(1,993,776)	(22,734,254)
Më 31 dhjetor 2021	269,884,527	360,921,420	130,341,156	250,276,717	519,494,522	1,530,918,342
Shtesa	31,668,303	36,467,783	9,584,604	14,139,568	90,681,964	182,542,221
Pakesime	(195,296)	(20,873,504)	-	(1,196,899)	(116,077)	(22,381,776)
Më 31 dhjetor 2022	301,357,534	376,515,700	139,925,759	263,219,386	610,060,408	1,691,078,787
Vlera e mbetur më 31 dhjetor 2021	1,101,684,057	180,862,444	37,906,663	121,785,671	334,609,401	1,776,848,236
Vlera e mbetur më 31 dhjetor 2022	1,073,386,527	147,853,255	36,845,197	206,427,347	304,051,566	1,768,563,895

Asnjë aktiv material afatgjatë nuk është vendosur si kolateral ndaj ndonjë huamarrje në 31 dhjetor 2022.

Marketing & Distribution Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)***4/1 AKTIVET AFATGJATA MATERIALE**

E drejta e përdorimit të aseteve me 31 dhjetor 2022 paraqitet si me poshte:

	E drejta e përdorimit të aseteve	Total
Kosto		
Gjendja me 31 dhjetor 2021	-	-
Shtesa	136,435,237	136,435,237
Pakesime	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2022	136,435,237	136,435,237
Amortizimi		
Gjendja me 31 dhjetor 2021	-	-
Shtesa	(30,450,699)	(30,450,699)
Pakesime	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2022	(30,450,699)	(30,450,699)
Vlera kontabel neto		
Gjendja me 31 dhjetor 2021	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2022	105,984,539	105,984,539

5. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

Aktivet afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë të përbëra si më poshtë:

	Vepra antike dhe te tjera	Total
Kosto		
Më 31 dhjetor 2020	2,083,200	2,083,200
Shtesa	337,333	337,333
Pakesime	-	-
Më 31 dhjetor 2021	2,420,533	2,420,533
Shtesa	4,086,161	4,086,161
Pakesime	-	-
Më 31 dhjetor 2022	6,506,695	6,506,695
Amortizimi i akumuluar		
Më 31 dhjetor 2020	-	-
Shtesa	-	-
Pakesime	-	-
Më 31 dhjetor 2021	-	-
Shtesa	-	-
Pakesime	-	-
Më 31 dhjetor 2022	-	-
Vlera e mbetur më 31 dhjetor 2021	2,420,533	2,420,533
Vlera e mbetur më 31 dhjetor 2022	6,506,695	6,506,695

Asnjë aktiv jo-material afatgjatë nuk është vendosur si kolateral ndaj ndonjë huamarrje më 31 dhjetor 2022 (asnjë: 31 dhjetor 2021).

Marketing & Distribution Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)***6. INVESTIME NË PJESËMARRJE**

Investimet në pjesëmarrje më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Emri i mire	260,693,050	260,693,050
Pjesmarrje Kavex	144,252,220	144,252,220
Aksione 3P Life Logistic	24,000,000	24,000,000
Totali	428,945,270	428,945,270

7. AKTIVET FINANCIARE

Aktivet Financiare më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Fond Investimi ABI	57,115,000	-
Totali	57,115,000	-

8. INVENTARËT

Inventarët më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Mallra	2,176,355,746	1,710,243,993
Inventar i imet	63,564,717	43,846,458
Provigjione	(5,039,012)	(1,441,111)
Totali	2,234,881,451	1,752,649,340

9. LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Kliente	1,264,017,756	1,109,982,874
Provigjione per kliente	(33,252,715)	(28,650,991)
Totali	1,230,765,041	1,081,331,883

Marketing & Distribution Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)***10. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë të detajuara si më poshtë:

	<u>Me 31 dhjetor 2022</u>	<u>Me 31 dhjetor 2021</u>
Te tjera te arketueshme	92,563,869	98,363,625
TVSH e arketueshme	20,872,678	-
Huadhenie afatgjate per pale te treta	5,312,348	5,827,247
Dividend te arketueshem	-	42,103,568
Total	118,748,895	146,294,440

11. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTET E TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Banka ne EUR	80,363,875	213,119,474
Banka ne LEK	41,946,675	64,569,136
Banka ne USD	11,257,905	12,864,333
Mjete monetare ne arke dhe te tjera	4,744,898	2,526,963
Totali	138,313,353	293,079,906

12. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali i shoqërisë sipas aktit të themelimit ka vlerën prej 83,041,330 LEK dhe përbëhet nga kontributi i Ortakut:

- Znj. Vilma Nushi 100 % të kapitalit të shoqërisë;

13. HUAMARRJE NGA INSTITUCIONET FINANCIARE

Huamarrje nga institucionet financiare më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Huamarrje OTP Bank	10,838,588	-
Huamarrje nga institucionet financiare	-	125,053,098
Totali	10,838,588	125,053,098

Marketing & Distribution Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)***14. DETYRIME TË TJERA AFATGJATA**

Detyrime të tjera afatgjata më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

	<u>Me 31 dhjetor 2022</u>	<u>Me 31 dhjetor 2021</u>
Huamarrje afatgjate nga palet e treta	1,406,783,850	1,222,703,781
Dividend te pagueshem	92,270,814	-
Totali	1,499,054,664	1,222,703,781

15. LLOGARITË E PAGUESHME TREGËTARE DHE TË TJERA

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë të detajuara si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Furnitorë ne monedhe te huaj	491,878,826	449,544,450
Furnitorë ne LEK	101,682,858	117,835,558
Magazina Doganore	(434,648,017)	(456,012,388)
Totali	158,913,667	111,367,620

16. DETYRIME TË TJERA AFATSHKURTRA

Detyrime të tjera afatgjata më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Te tjera te pagueshme	86,964,261	87,235,342
Paga te pagueshme	21,766,550	20,386,457
Totali	108,730,811	107,621,799

17. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Tatim ne Burim	681,667	370,250
TVSH e pagueshme	-	10,844,373
Totali	681,667	11,214,623

Marketing & Distribution Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)***18. TE ARDHURAT NGA SHITJA E MALLRAVE DHE SHERBIMEVE**

Të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë të përbëra si më poshtë:

	Per vitin qe mbyllet me 31 dhjetor 2022	Per vitin qe mbyllet me 31 dhjetor 2021
Te ardhura nga shitja e produkteve ushqimore dhe te pastertise	8,379,233,173	7,841,344,985
Te ardhura te tjera	101,480,293	181,203,017
Total	8,480,713,466	8,022,548,002

19. KOSTO E MALLRAVE TE SHITURA

Kosto e mallrave të shitura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë të përbëra si më poshtë:

	Per vitin qe mbyllet me 31 dhjetor 2022	Per vitin qe mbyllet me 31 dhjetor 2021
KMSH e produkteve ushqimore dhe te pastertise	6,934,702,909	6,621,071,605
Total	6,934,702,909	6,621,071,605

20. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë të përbëra si më poshtë:

	Per vitin qe mbyllet me 31 dhjetor 2022	Per vitin qe mbyllet me 31 dhjetor 2021
Shpenzime page	324,493,975	316,625,623
Shpenzime sigurimesh shoqerore	53,630,266	53,154,898
Total	378,124,241	369,780,521

Marketing & Distribution Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)***21. SHPENZIME OPERATIVE DHE TE TJERA**

Shpenzime të tjera operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë të detajuara si më poshtë:

	Per vitin qe mbyllet me 31 dhjetor 2022	Per vitin qe mbyllet me 31 dhjetor 2021
Sherbime promocioni dhe reklama	190,286,861	381,230,458
Shpenzime te aktivitetit	99,755,972	-
Shpenzime karburanti	59,837,638	41,633,222
Shpenzime qeraje	47,381,448	46,493,565
Mirembajtje dhe riparime makina	36,041,808	20,339,767
Shpenzime udhetime e dieta	31,488,484	29,082,674
Shpenzime te tjera	30,877,551	16,220,608
Shpenzime te ndryshme	28,480,444	12,142,579
Shpenzime perfaqesimi	18,013,820	9,106,247
Energji elektrike dhe utilitete te tjera	14,818,497	10,401,444
Komisione bankare	11,098,805	9,874,150
Mirembajtje dhe riparime IT	10,396,946	10,078,517
Shpenzime trasporti	10,105,666	7,403,753
Mirembajtje dhe riparime te tjera	9,391,369	6,384,390
Shpenzime komunikimi	8,597,008	8,236,772
Siguracione	8,467,409	11,042,018
Konsulenca	8,361,554	4,607,989
Shpenzime per provigjione	8,199,624	9,098,730
Shpenzime ruajtjeje	6,282,243	5,700,052
Taksa vjetore	4,565,627	4,448,126
Shpenzime skanim maune	4,436,959	4,624,926
Vlera e mbetur e AAM te shitura	3,181,687	4,300,426
Shpenzime amortizimi qera financiare	1,340,821	-
Shpenzime Doganore	1,247,013	2,392,280
Certifikime	691,116	831,975
Sponsorizime	550,000	371,470
Gjoba	224,569	680,816
Total	654,120,939	656,726,953

22. TË ARDHURAT FINANCIARE

Të ardhurat financiare përbëhen nga komisionet kredie ,shpenzime interesi dhe fitim nga kursi i kembimit me vlere 3,393,213 lek.

23. TATIMI MBI FITIMIN

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021
Fitimi i vitit para tatimit	334,616,370	189,733,939
Shtese: Shpenzime te pazbritshme	19,322,780	43,645,419
Te ardhura te patatueshme	-	-
Fitimi fiskal i vitit	353,939,150	233,379,358
Fitimi neto i tatueshem	353,939,150	233,379,358
Tatim fitimi me 15% (2021: 15%)	53,090,872	35,006,904
Tatim fitimi per t'u paguar	17,920,774	-
Tatim fitimi per t'u paguar/(arketuar)	71,011,646	35,006,904

24. ANGAZHIME DHE PASIGURI*Kërkesa ligjore*

Gjatë aktivitetit normal të saj, Shoqëria mund të jetë subjekt i kërkesave të ndryshme ligjore. Më 31 dhjetor 2022, Shoqëria nuk ka patur pretendime ligjore, të cilat konsiderohen normale gjatë rrjedhës së aktivitetit të saj.

Angazhimet

Nuk ka zotime të rëndësishme kapitale të kontraktuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, që nuk janë njohur tashmë në pasqyrat financiare.

25. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Transaksionet me palët e lidhura paraqesin një transferim të burimeve, shërbimeve apo detyrimeve ndërmjet palëve të lidhura, pavarësisht nëse është vënë një çmim. Një palë e lidhur është një parti që kontrollon, ose nëse ka një interes në njësinë ekonomike që i jep ndikim domethënës mbi njësinë ekonomike; ose nëse ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike; apo është anëtar i personelit drejtues kryesor të njësisë ekonomike ose mëmë së saj (duke përfshirë edhe anëtarët e familjes së ngushtë të ndonjë prej personave të përmendur më lart). Kontrolli është fuqia për të drejtuar politikën financiare dhe operative të një entiteti në mënyrë që të marrë përfitime nga veprimtaritë e saj. Kontrolli presupozohet se ekziston, kur mëma, zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi më shumë se gjysmën e të drejtave të votës së filialit.

Gjatë aktivitetit të saj, shoqëria kryen transaksione me palët e lidhura.

26. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR**26.1 Faktorët e rrezikut financiar**

Aktiviteti i Shoqërisë e ekspozon atë ndaj disa rreziqesh financiare, duke përfshirë rrezikun e kredisë, rrezikun nga kurset e këmbimit dhe rrezikun e normave të interesit. Administrimi i rrezikut të Shoqërisë përqëndrohet në paparashikueshmërinë e tregut dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi performancën e biznesit të Shoqërisë.

Administrimi i rrezikut bëhet nga drejtimi duke u bazuar në disa politika e procedura të shkruara dhe të aprovuara, të cilat mbulojnë të gjithë administrimin e rrezikut dhe pjesë specifike si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normave të interesi, rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit.

26.2 Rreziku i tregut*Rreziku nga kurset e këmbimit*

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen prej ekspozimit ndaj monedhave të huaja, kryesisht ndaj monedhës së Euros. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për t'u mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit. Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur një pozicion të përshtatshëm neto në çdo monedhë dhe në total si dhe të monitorojë operacionet me bazë ditore.

Vlera e mbartur e aktiveve dhe detyrimeve të Shoqërisë në monedhë të huaj është si më poshtë:

Më 31 dhjetor 2022	Vlera kontabël	EUR	LEK	USD
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	138,313,353	80,363,875	46,691,573	11,257,905
Llogari te arketueshme	1,349,744,628	-	1,349,744,628	-
Llogaritë e pagueshme	(267,644,478)	(576,251,307)	290,289,600	18,317,229
Ekspozimi neto	1,220,413,503	(495,887,432)	1,686,725,801	29,575,134

Më 31 dhjetor 2021	Vlera kontabël	EUR	LEK	USD
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	293,079,906	213,381,413	66,834,160	12,864,333
Llogari te arketueshme	1,227,626,324	-	1,227,626,324	-
Llogaritë e pagueshme	(197,338,844)	(29,287,459)	(168,051,384)	-
Ekspozimi neto	1,323,367,386	184,093,954	1,126,409,100	12,864,333

Marketing & Distribution Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022***(shumat janë të shprehura në LEK, përveç se kur shprehet ndryshe)***27. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****27.2 Rreziku i tregut (vazhdim)***Analiza e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit*

31 dhjetor 2022			<u>Fitim ose humbje</u>	
	Vlera e ekspozimit, neto	10%	-10%	
EURO	1,220,413,503		122,041,350	(122,041,350)
31 dhjetor 2021			<u>Fitim ose humbje</u>	
	Vlera e ekspozimit, neto	10%	-10%	
EURO	1,323,367,386		132,336,739	(132,336,739)

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm mjetet monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit dhe një korrigjim i vlerave të tyre është bërë për shkak të një ndryshimi me 10% të kurseve të këmbimit. Vlera pozitive/negative tregon rritje/ulje në fitim ose elemente të tjerë të kapitalit, gjë që ndodh kur monedha Lek dobësohet/forcohet në krahasim me monedhat e tjera të huaja me +/- 10%.

27.3 Rreziku i likuiditetit

Shoqëria i drejton nevojat e saj për likuiditet duke monitoruar me kujdes pagesat e huave të skeduluara dhe duke parashikuar hyrjet dhe daljet e parave bazuar në rrjedhën e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditet monitorohen në grupime të ndryshme kohore. Nevojat neto për mjete monetare në arkë krahasohen me mjetet e disponueshme të huamarrjes në mënyrë që të përcaktohet çdo humbje. Kjo analizë tregon nëse mjetet e disponueshme të huamarrjes janë të mjaftueshme për periudhën në shqyrtim. Shoqëria mban para në arkë dhe bankë për të përmbushur nevojat e saj për likuiditet për një periudhë minimale prej 30 ditësh.

Më 31 dhjetor 2022	Afatshkurtra	Afatgjata	
	1 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	138,313,353	-	-
Llogaritë e arketueshme dhe te tjera	1,079,795,702	269,948,926	-
Llogaritë e pagueshme dhe te tjera	(214,115,582)	(53,528,896)	-
Detyrime te tjera afatgjata	-	(299,821,033)	(1,199,284,134)
Totali	1,003,993,473	(83,401,003)	(1,199,284,134)

Më 31 dhjetor 2021	Afatshkurtra	Afatgjata	
	1 deri në 12muaj	1 deri në 5vjet	Më shumë se 5vjet
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	293,079,906	-	-
Inventaret, Llogaritë e arketueshme dhe te tjera	1,227,626,324	-	-
Llogaritë e pagueshme dhe te tjera	(197,338,844)	-	-
Detyrime te tjera afatgjata	-	(1,347,756,881)	-
Totali	1,323,367,386	(1,347,756,881)	-

27. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

27.4 Vlerësimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë përfaqëson çmimin që do të merret për të shitur një aktiv ose çmimin që do të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion normal ndërmjet pjesëmarësve në treg në datën e matjes.

28. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka pasur ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim apo paraqitje në pasqyrat financiare.